# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5925
E premte, 8 nëntor 2019
çmimi 0.40 €


## Haradinaj: 29 projektligje i dedikohen zhvillimit ekonomik FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA PUBLIKUAR REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT FAQE 4-5

# ZYRTARE: VETËVENDOSJA FITUESE E ZGJEDHJEVE, NISMA-AKR MBETEN JASHTË KUVENDIT

**- LV-ja 32 deputetë, LDK-ja 29, PDK-ja 25, AAK-PSD 14, Lisa Serbe 10 dhe minoritetet e tjera 10 deputetë**

Sipas rezultateve përfundimtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit dhe do t'i ketë 32 deputetë. Në vendin e dytë është renditur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 29 deputetë. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dalë e treta me 25 deputetë. Koalicioni AAK-PSD është radhitur i katërti dhe ka marrë 14 deputetë. Lista Srpska ka dalë subjekti i pestë politik në vend dhe do t'i ketë 10 deputetë. Dhjetë deputetë do t'i kenë edhe minoritetet e tjera joshumicë. Ndërkaq koalicioni Nisma-AKR-PD nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor



Foto: REL

## Koalicioni Nisma-AKR-PD nuk e pranon rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit

## OPINION

### KUJDES ME FQINJËT: AS SUPERIORITET DHE AS INFERIORITET, POR DINJITET F. 10-11



Prof. Dr. Lisen BASHKURTI



# Veseli më 4 dhjetor intervistohet nga Gjykata Speciale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale me seli në Hagë. Ai në një konferencë për media ka bërë me dije se nga Specialja do të intervistohet më 4 dhjetor në Hagë. "Jam i bindur se edhe kjo gjykatë do ta vërtetojë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe që do t'i ndalë goditjet ndaj të vërtetës së popullit tonë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë do t'i përgjigjem kësaj ftese më 4 dhjetor", ka deklaruar Veseli

## AKTUALE

### KRYEQYTETI I KOSOVËS DO TË BËHET ME SHTATOREN E ADEM JASHARIT F. 5

### NË DHJETOR ARRIJNË 100 000 VAKSINA KUNDËR GRIPIT F. 6

### POLICËT E RINJ NËNSHKRUAJNË KONTRATAT F. 3

## EKONOMI

### STABILITETI I KOSOVËS ËSHTË PARAKUSHT KYÇ PËR TËRHEQJEN E INVESTIMEVE F. 8

### FABRIKA E NGJYRAVE 'RELUX', BIZNES I DIASPORËS NË KOSOVË, FILLON EKSPORTIN NË KINË F. 8


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Hahni: Perspektiva evropiane, garancia e vetme për Ballkanin



BRUKSEL, 7 NËNTOR - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, tha se perspektiva e integrimit evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor është garancia e vetme për zhvillimin e këtij rajoni. Hahni tha se duhet bërë gjithçka e mundur për të tejkaluar vakuumin, i cili është krijuar pas vendimit të Këshillit Evropian për të shtyrë datën e nisjes së bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.
Motivimi më i madh i këtyre vendeve është mundësia e anëtarësimit në BE, tha Hahni.
"Ballkani Perëndimor nuk është një periferi e Evropës, por pjesë e Evropës. Nuk mund të kemi një situatë ku e gjithë popullsia mbetet prapa. Do të gjendeshim në vakuum dhe kjo do të mund të krijonte rrezik për sigurinë", tha Hahni, duke folur para Komitetit të Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian.
Ai theksoi se perspektiva evropiane gjithashtu do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.
"Nga pikëpamja serbe, ideja e një marrëveshjeje midis dy vendeve do të kishte kuptim vetëm nëse do të ekzistonte perspektiva e pranimit në BE", tha Hahni.
Ky ishte adresimi i fundit i tij si komisionar përgjegjës për zgjerimin.
Hahni do të jetë komisionar edhe në përbërjen e re të Komisionit Evropian, që pritet të nisë punën muajin e ardhshëm, por do të merret me çështjet e buxhetit.
Në tetor, Këshilli Evropian nuk është pajtuar për nisjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Kundërshtimet më të mëdha kanë ardhur nga Franca, e cila ka kërkuar nga këto dy vende të vazhdojnë reformat, por ka theksuar edhe nevojën e reformimit të vetë BE-së.

# Macroni: Gjysma e BE-së ishte kundër negociatave me Shqipërinë

Presidenti francez Emannuel Macron ka thënë se hapja e një procesi thjesht burokratik është absurd dhe shumica e vendeve të BE-së, ishin në favor të hapjes së negociatave për Maqedoninë e Veriut, por gati gjysma e tyre ishin kundër hapjes për Shqipërinë



PARIS, 7 NËNTOR - Presidenti francez, Emmanuel Macron ka zbuluar të enjten se kundër vendimit për hapjen e negociatave me Shqipërinë nuk ishte vetëm Franca, por edhe shumë vende të tjera.
Ai tha se se nëse negociatat do të hapeshin vetëm për Maqedoninë e Veriut, Shqipëria do të ishte poshtëruar dhe i gjithë rajoni i Ballkanit do të hynte në spiralet e një destabilizimi eventual. "Hapja e një procesi thjesht burokratik është absurd dhe shumica e vendeve të BE-së, ishin në favor të hapjes së negociatave për Maqedoninë e Veriut, por gati gjysma e tyre ishin kundër hapjes për Shqipërinë. Gabim fatal. Realiteti është që nëse nuk do t'i hapnim negociatat vetëm për Shqipërinë, do të shkaktonim një traumë të tmerrshme në rajon. Ka komunitete shqipfolëse kudo. Nëse poshtëroni Shqipërinë, ju do të destabilizoni rajonin në një mënyrë të qëndrueshme", është shprehur Macron.
Presidenti francez duket i vendosur kundër zgjerimit, duke thënë se procesi është i pakuptimtë. "Është absurde të hapësh një proces thjesht burokratik", tha ai. Macroni tha se pretendimet për ndikimin rus, kinez apo turk nëse nuk hapen negociatat nuk qëndron. Sipas tij, "ka vende që kanë hapur negociatat, por sërish ndjehet ndikimi i këtyre influencave". Kreu i shtetit francez këmbëngul se duhet rishikuar procedura e ndjekur nga BE-ja.
Ndërkohë po të enjten, ambasadori i Francës në Beograd përveç qëndrimit diplomatik për refuzimin e negociatave për shkak të reformimit të BE-së, ka folur dhe për çështje konkrete që lidhen me reforma, në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut. Në një intervistë për medien serbe, ai deklaron se Shqipëria ende nuk ka përfunduar reformën në drejtësi duke nënkuptuar se mungesa e reformave ishte një tjetër arsye mbi të cilën u mor vendimi për të mos caktuar datë për negociatat.
"Ajo që ndodhi, çështja se a do t'i hapim negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, duhet të them se ato vende jashtëzakonisht u përpoqën, veçanërisht me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës. Por, çështja për zgjerimin, është përcaktim konkret për reforma, veçanërisht ajo ishte kërkesë për Maqedoninë e Veriut, reforma e PSP-së, reforma e gjyqësisë në Shqipëri. Ishin parashtruar kushte të caktuara dhe ato kushte nuk ishin plotësuar. Por, ndoshta disa partnerë në BE kanë konsideruar se edhe krahas të gjithave, duhej të hapen negociatat, ndërsa presidenti i Francës, Emanuel Makron dëshironte të mbajë një pozitë koherente, që do të thotë se ekzistojnë kushte për inkuadrim në BE, të cilat vlejnë edhe për Serbinë dhe të tjerat, dhe ato kushte duhet të plotësohen. Këtu nuk ka tërheqje, sepse tërheqjet kanë lidhje me modelin për përcjellje. Duhet që vendet t'i zbatojnë reformat e nevojshme. Etapat duhet të respektohen. Nëse nga vetë fillimi vazhdojmë të "lëvizim" rreth kushteve, do të kemi proces rrëshqitës", deklaroi ambasadori i Francës në Serbi, Zhan Luj Falkoni.

## Basha: Unë nuk kam asnjë lidhje me oligarkinë



TIRANË, 7 NËNTOR - Jo vetëm që nuk pranoi se ka lidhje me oligarkinë, por lideri demokrat Lulzim Basha foli në Vlorë edhe për planin që ka për të çarmatosur oligarkinë nga instrumentet me të cilat kap shtetin dhe pushtetin.
"Unë nuk kam asnjë lidhje me oligarkinë. Përkundrazi! Unë dhe partia ime kemi një plan për ta çarmatosur oligarkinë nga instrumentat me të cilat kap shtetin dhe pushtetin dhe, pastaj, vjedh dhe grabit pasuritë e shqiptarëve, siç kemi edhe ësjtë një plan për t'u marrë çdo qindarkë që i kanë marrë nga taksat tuaja dhe për t'jua rikthyer ju", tha kreu i opozitës.
Basha tha se ndryshe nga kundërshtari i tij politik, nuk ka asnjë lidhje me persona me rekorde kriminale.
"Çfarë kam unë ndryshe? Është e vështirë të flasësh për veten, por e kam për detyrë ta shpjegoj, përderisa e kërkoj këtë përgjegjësi. E kam për detyrë t'ju them se ndryshe nga ky që qeveris sot, unë nuk kam lidhje me asnjë kriminel dhe nuk jam mbështetur kurrë te kriminelët për pushtetin tim apo të partisë sime. Përkundrazi! Ne kemi bërë një betejë 6-vjeçare kundër krimit dhe kemi fituar disa segmente të kësaj beteje, siç është për shembull Ligji për Dekriminalizimin, që ka nxjerrë shumë pushtetarë nga Parlamenti, nga bashkitë. I fundit ishte ky i Vorës", tha Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur konferencë për media

# Veseli më 4 dhjetor intervistohet nga Gjykata Speciale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale me seli në Hagë. Ai në një konferencë për media ka bërë me dije se nga Specialja do të intervistohet më 4 dhjetor në Hagë. "Jam i bindur se edhe kjo gjykatë do ta vërtetojë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe që do t'i ndalë goditjet ndaj të vërtetës së popullit tonë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë do t'i përgjigjem kësaj ftese më 4 dhjetor", ka deklaruar Veseli



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka marrë ftesë nga Gjykata Speciale. Ai do të intervistohet më 4 dhjetor në Hagë. "Si një nga udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë sot kam pranuar ftesë nga Dhomat e Specializuara, për t'u intervistuar më 4 dhjetor në Hagë. Jam zotuar se, sapo ta kem një ftesë të tillë, do ta bëj publike. Gjenerata ime, si shumë gjenerata të tjera, ka përjetuar shtypjen e rëndë të kombit tonë. Ne nuk jemi pajtuar me atë gjendje dhe unë jam krenar që i jam përgjigjur thirrjes së vendit për lirinë e kombit", ka thënë Veseli në një konferencë për media.

Veseli ka thënë se gjithë jetën ka qenë i angazhuar për të mirën e Kosovës dhe këtë, siç ka thënë ai, e ka bërë tërësisht në baza vullnetare dhe me përkushtimin më të lartë. "E kam nisur si fëmijë, si nxënës i shkollës fillore në Mitrovicë, me demonstratat e prillit të vitit 1981, si pjesëmarrës, e pastaj në shumicën prej tyre edhe si organizator dhe drejtues. Nga mesi i viteve '80 unë kam hyrë me ideal në organizatat patriotike antijugosllave për ta kundërshtuar robërinë dhe për të punuar për lirinë. Epoka e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është pjesa më krenare e jetës sime", është shprehur ai.

Veseli ka shtuar se ka qenë i bekuar që ishte një ndër ideatorët dhe themeluesit e UÇK-së, luftëtar i lirisë deri në çlirimin e vendit. "Nga prilli i vitit 1999, deri në qershor të vitit 2008, kam udhëhequr Shërbimin Informativ të Kosovës. Të gjitha këto angazhime i kam bartur me nder dhe përgjegjësi të plotë e me krenari të jashtëzakonshme. Përpjekjet e kombit tonë për liri kanë qenë jeta jonë. Të gjithë së bashku arritëm lirinë dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës është simboli i saj. Por, duhet pranuar një fakt, lufta e drejtë e popullit tonë për liri ka qenë e sulmuar vazhdimisht. Që nga paslufta ky është procesi i pestë i drejtësisë së cilës i nënshtrohet kjo luftë. Duke filluar nga UNMIK-u, e për të vazhduar me Gjykatën e Hagës, EULEX-in, drejtësinë vendore dhe tani me Gjykatën Speciale. Nuk besoj që në historinë e lëvizjeve çlirimtare të ketë pasur një shembull të tillë", është shprehur lideri i PDK-së.

Veseli ka theksuar se edhe ky proces duhet të ketë epilog, duke u bazuar në të vërtetën, faktet e drejtësinë dhe që nuk e dëmton shtetin e Kosovës në pafundësi. "Jam i bindur se edhe kjo gjykatë do ta vërtetojë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe që do t'i ndalë goditjet ndaj të vërtetës së popullit tonë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë do t'i përgjigjem kësaj ftese, më 4 dhjetor", ka deklaruar Veseli.

Prokuroria Speciale, deri më tash, ka ftuar për intervistim rreth 100 persona, ndër ta edhe disa prej ish-figurave të larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që pas luftës ishin dhe janë pjesë e skenës politike të Kosovës. Në mesin e tyre: Rrustem Mustafa, Sami Lushtaku, Shukri Buja dhe Ramush Haradinaj.

## Thaçi: Nuk ka gjykatë që mund ta njollosë Veselin dhe luftën e tij për çlirim

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka reaguar pas marrjes së lajmit se kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale. Thaçi ka thënë se fatin e viteve të gjata të robërisë dhe sundimit të popullit të Kosovës nga Serbia e ka ndryshuar përgjithmonë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe angazhimi i të rinjve e të rejave që iu bashkëngjitën UÇK-së në luftë për liri dhe pavarësi. "Lufta jonë për liri është kauza më e pastër, më e drejtë dhe më fisnike që mund ta ketë për fat një popull në historinë e tij. Kam pasur nderin e madh që për lirinë e Kosovës që nga fillimi të rrugëtoj vazhdimisht me Kadriun dhe në çdo hap jam ndier krenar me punën dhe angazhimin e tij të pa shoq, tash e tri dekada. Nuk ka asnjë dyshim se z. Veseli si edhe dhjetëra ish-luftëtarë të UÇK-së, që tashmë janë ftuar nga Dhomat e Specializuara, ka pasur moralin më të lartë patriotik, politik dhe ushtarak", ka thënë Thaçi në deklaratën e tij për media.

Presidenti ka shtuar se nuk ka gjykatë, as tendencë dhe as fabrikim që mund ta njollosë Veselin dhe luftën e tij për çlirim. "Nuk ka gjykatë, as vendore e as ndërkombëtare, që mund ta njollosë luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ballafaqimi me këto pretendime do ta vulosë përgjithmonë dinjitetin e UÇK-së dhe do t'i diskreditojë e nihilizojë përgjithmonë fabrikimet në dëm të saj. Nuk ka gjykatë, as vendore e as ndërkombëtare, që do të mund ta rishkruaj historinë dhe ta barazojë viktimën me agresorin", ka thënë Thaçi.



## Policët e rinj nënshkruajnë kontratat

PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Të enjten në sallën e Stacionit Policor "Qendra" në Prishtinë ka filluar nënshkrimi i kontratave për kandidatët e gjeneratës së 55-të për zyrtarë policorë të cilët do ta fillojnë trajnimin më 11 nëntor 2019 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Nënshkrimi i kontratave nga kadetët do të vazhdojë edhe sot (e premte). Gjenerata e 55-të do t'i ketë gjithsejtë 446 kadetë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare t

# Zyrtare: Vetëvendosja fituese e zgjedhjeve,




## - LV-ja 32 deputetë, LDK-ja 29, PDK-ja 25, AAK-PSD 14, Lisa Serbe 10 dhe minoritetet e tjera 10 deputetë

Sipas rezultateve përfundimtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit dhe do t'i ketë 32 deputetë. Në vendin e dytë është renditur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 29 deputetë. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dalë e treta me 25 deputetë. Koalicioni AAK-PSD është radhitur i katërti dhe ka marrë 14 deputetë. Lista Srpska ka dalë subjekti i pestë politik në vend dhe do t'i ketë 10 deputetë. Dhjetë deputetë do t'i kenë edhe minoritetet e tjera joshumicë. Ndërkaq koalicioni Nisma-AKR-PD nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 6 tetor. Sipas këtyre rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dalë subjekti i parë politik në vend me 220 811 vota apo 26.15 për qind. Vetëvendosje në Kuvend do t'i ketë 32 deputetë.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është renditur subjekti i dytë me 206 458 vota apo 24.45 për qind. LDK-ja në legjislaturën e shtatë do të përfaqësohet me 29 deputetë.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është radhitur e treta, duke marrë 178 645 vota apo 21.16 për qind. PDK-ja në këtë mandat do t'i ketë në Kuvendin e Kosovës 25 deputetë.

Koalicioni AAK-PSD në zgjedhjet e 6 tetorit ka marrë 96 883 vota apo 11.47 për qind. AAK-ja do t'i ketë 13 deputetë, ndërsa PSD-ja do ta ketë vetëm një deputete.

Ndërkohë Lista Srpska ka dalë subjekti i pestë politik në vend me 57 015 vota apo 6.75 për qind dhe do t'i ketë 10 deputetë.

Dhjetë deputetë do t'i kenë edhe minoritetet e tjera joshumicë.

Koalicioni Vakat dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) do të përfaqësohen me nga dy deputetë, ndërsa me nga një deputet në Kuvendin e Kosovës do të përfaqësohen Partia Egjiptiane e Kosovës, Partia e Ashkalinjve për Integrim, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Nova Demokratska Stranka dhe Jedinstvena Goranska Partija.

Në një konferencë për medie kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije se pjesëmarrja në zgjedhjet e 6 tetorit ka qenë 44.72 për qind. "Janë statistikat e përgjithshme, numri i votuesve të regjistruar ka qenë një milion e 961 mijë votues. Numri i votuesve që kanë votuar jashtë vendvotimeve është mbi 50 mijë dhe pjesëmarrja në votime është 44,72 për qind. Numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme është 844 121 fletëvotime, të pavlefshme 25 485", ka thënë ajo.

Bazuar në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit në grupet parlamentare të partive politike do të shihen edhe

## Petricek: Republika Çeke nuk e rishikon vendimin për njohjen e Kosovës



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Ministri i Jashtëm i Republikës Çeke, Tomas Petricek, ka thënë se vendi i tij nuk po e rishikon vendimin për njohjen e Kosovës, ndonëse presidenti çek, Millosh Zeman, ka paralajmëruar se mund të ndodhë një gjë e tillë. Petricek, në intervistën dhënë "Radios Evropa e Lirë", e quan dështim vendimin e Këshillit Evropian për të mos nisur negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Petricek në këtë intervistë ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe ndikimin rus në rajon.

:ë 6 tetorit

# Nisma-AKR mbeten jashtë Kuvendit




shumë fytyra të reja të cilat do të ulen në karrigen e deputetit për herë të parë. 50 për qind e deputetëve të LV-së, 16 nga 32 do të jenë për herë të parë. Ky numër mund të rritet me marrjen e posteve ekzekutive të disa prej deputetëve që janë në krye të listës. Në LDK, 12 nga 29 deputetët do të ulen në Kuvend për herë të parë. Edhe te LDK-ja ky numër mund të rritet nëse realizohet koalicioni me LV-në. Po ashtu, edhe te PDK-ja, 15 nga 25 deputetët janë të rinj. Ndërsa AAK-ja ka vetëm katër deputetë që marrin mandatin për herë të parë, prej të cilëve një është nga PSD-ja. Edhe Lista Serbe do t'i ketë 5 deputetë të ri, kurse KDTP-së i mungon Mufera Sinik.

## EMRAT DHE VOTAT E DEPUTETËVE TË RINJ TË KUVENDIT TË KOSOVËS

### 32 DEPUTETËT E VETËVENDOSJES

| | |
|---|---|
| 1. Albin Kurti | 183 868 |
| 2. Glauk Konjufca | 72 775 |
| 3. Albulena Haxhiu | 46 861 |
| 4. Arben Vitia | 26 074 |
| 5. Hekuran Murati | 23 274 |
| 6. Mimoza Kusari Lila | 22 553 |
| 7. Liburn Aliu | 18 535 |
| 8. Saranda Bogujevci | 18 518 |
| 9. Rexhep Selimi | 16 096 |
| 10. Haki Abazi | 15 922 |
| 11. Yllza Hoti | 14 810 |
| 12. Mefail Bajqinovci | 14 494 |
| 13. Labinotë Demi-Murtezi | 13 595 |
| 14. Hajrulla Çeku | 12 163 |
| 15. Valon Ramadani | 12 136 |
| 16. Jahja Kokaj | 12 119 |
| 17. Gazmend Gjyshinca | 12 104 |
| 18. Arberije Nagavci | 11 110 |
| 19. Fitore Pacolli-Dalipi | 10 944 |
| 20. Artan Abrashi | 10 442 |
| 21. Shpejtim Bulliqi | 10 252 |
| 22. Arbër Rexhaj | 9 595 |
| 23. Agon Batusha | 9 261 |
| 24. Salih Zyba | 8 462 |
| 25. Dimal Basha | 8 342 |
| 26. Arbëreshë Kryeziu-Hyseni | 8 315 |
| 27. Fatmire Kollçaku | 8 126 |
| 28. Fitim Uka | 8 010 |
| 29. Fjolla Ujkani | 7 952 |
| 30. Alban Hyseni | 7 833 |
| 31. Enver Haliti | 7 723 |
| 32. Arta Bajralija | 7 670 |

### 29 DEPUTETËT E LDK-SË

| | |
|---|---|
| 1. Vjosa Osmani-Sadriu | 176 188 |
| 2. Kujtim Shala | 39 091 |
| 3. Anton Quni | 31 816 |
| 4. Lumir Abdixhiku | 29 565 |
| 5. Avdullah Hoti | 26 155 |
| 6. Besian Mustafa | 18 434 |
| 7. Marigona Geci | 17 740 |
| 8. Driton Selmanaj | 16 213 |
| 9. Arban Abrashi | 14 181 |
| 10. Ekrem Hyseni | 13 605 |
| 11. Fetah Rudi | 12 648 |
| 12. Frasher Demaj | 12 323 |
| 13. Shkëmb Manaj | 11 420 |
| 14. Arben Gashi | 10 678 |
| 15. Armend Zemaj | 10 622 |
| 16. Ardian Shala | 9 382 |
| 17. Haxhi Avdyli | 9 245 |
| 18. Vlora Limani-Hajnuni | 8 944 |
| 19. Rrezarta Krasniqi | 8 878 |
| 20. Shkëlzen Hajdini | 8 776 |
| 21. Lirije Kajtazi | 8 685 |
| 22. Ilir Ferati | 8 598 |
| 23. Fatmir Rexhepi | 8 473 |
| 24. Hykmete Bajrami | 8 407 |
| 25. Ilir Tasholli | 7 973 |
| 26. Doruntinë Maloku-Kastrati | 7 949 |
| 27. Hatim Baxhaku | 7 905 |
| 28. Besa Gaxherri | 7 082 |
| 29. Valentina Bunjaku-Rexhepi | 7 066 |

### 25 DEPUTETËT E PDK-së

| | |
|---|---|
| 1. Kadri Veseli | 146 763 |
| 2. Uran Ismaili | 28 250 |
| 3. Mergim Lushtaku | 18 539 |
| 4. Ferat Shala | 18 334 |
| 5. Elmi Reçica | 17 946 |
| 6. Bedri Hamza | 15 471 |
| 7. Abelard Tahiri | 14 579 |
| 8. Kujtim Gashi | 13 335 |
| 9. Bajrush Xhemajli | 11 664 |
| 10. Enver Hoxhaj | 11 157 |
| 11. Memli Krasniqi | 11 034 |
| 12. Hajredin Kuçi | 10 680 |
| 13. Bekim Haxhiu | 10 538 |
| 14. Sejdi Hoxha | 9 676 |
| 15. Fatmir Xhelili | 9 347 |
| 16. Eliza Hoxha | 9 303 |
| 17. Gazmend Bytyçi | 9 119 |
| 18. Fadil Nura | 9 019 |
| 19. Ariana Musliu -Shoshi | 8 831 |
| 20. Ganimete Musliu | 8 397 |
| 21. Evgjeni Thaçi -Dragusha | 8 365 |
| 22. Blerta Deliu-Kodra | 8 099 |
| 23. Besa Ismaili-Ahmeti | 7 887 |
| 24. Floretë Zejnullahu | 7 046 |
| 25. Valdete Idrizi | 6 236 |

### 14 DEPUTETËT E KOALICIONIT AAK-PSD

| | |
|---|---|
| 1. Ramush Haradinaj | 75 917 |
| 2. Daut Haradinaj | 23 784 |
| 3. Bekë Berisha | 11 980 |
| 4. Pal Lekaj | 10 351 |
| 5. Time Kadrijaj | 8 061 |
| 6. Rasim Selmanaj | 8 022 |
| 7. Gazmend Syla | 7 753 |
| 8. Ali Berisha | 7 381 |
| 9. Arber Tolaj | 7 230 |
| 10. Shkumbin Demaliaj | 6 761 |
| 11. Albena Reshitaj | 6 040 |
| 12. Teuta Haxhiu | 5 926 |
| 13. Donika Kadaj-Bujupi | 5 295 |
| 14. Natyra Kuçi | 4 452 |

### 10 DEPUTETËT E LISTËS SERBE

| | |
|---|---|
| 1. Jasmina Dediç | 19 703 |
| 2. Milos Peroviç | 17 276 |
| 3. Verica Ceraniç | 17 065 |
| 4. Igor Simiç | 16 566 |
| 5. Zoran Mojsiloviç | 15 386 |
| 6. Ivan Todosijeviç | 14 894 |
| 7. Miljana Nikoliç | 14 790 |
| 8. Branislav Nikoliç | 14 467 |
| 9. Ljubinko Karadziç | 14 354 |
| 10. Slavko Simiç | 14 231 |

### 10 DEPUTETËT E MINORITETEVE TË TJERA

Koalicioni Vakat

| | |
|---|---|
| 1. Rasim Demiri | 3 288 |
| 2. Duda Balje | 2 747 |

#### PARTIA DEMOKRATIKE TURKE E KOSOVËS (KDTP)

| | |
|---|---|
| 1. Fikrim Damka | 2 918 |
| 2. Fidan Jilta | 2 578 |

#### PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE

| | |
|---|---|
| 1. Veton Berisha | 3 121 |

#### PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

| | |
|---|---|
| 1. Etem Arifi | 2 055 |

#### NOVA DEMOKRATSKA STRANKA

| | |
|---|---|
| 1. Emilija Redzepi | 288 |

#### JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA

| | |
|---|---|
| 1. Adem Hodza | 633 |

#### PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS

1. Albert Kinolli 666

#### INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS

| | |
|---|---|
| 1. Elbert Krasniqi | 962 |

# Votat e kandidatëve për kryeministër

Në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit më së shumti vota kanë marrë pesë kandidatët për kryeministër nga radhët e tri subjekteve politike dhe dy koalicioneve parazgjedhore. Kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, është lideri më i votuar i këtyre zgjedhjeve, me 183 868 vota. Kurse kandidatja e dytë më e votuar është Vjosa Osmani nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 176 188 vota. Ndërkaq kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është lideri i tretë më i votuar me 146 763 vota. Në vendin e katërt është renditur kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, me 75 917 vota, kurse në të pestin kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, me 26 014 vota.

## Kryeqyteti i Kosovës do të bëhet me shtatoren e Adem Jasharit



**Prishtinë, 7 nëntor (ER)** - Pas 20 vjet pritjeje, komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Adem Jashari, do të bëhet me shtatore në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Lajmin e ka bërë me dije, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook", drejtori i Inspeksionit në Komunën e Prishtinës, Adonis Tahiri. "Më në fund, sheshi kryesor i Prishtinës do ta ketë edhe shtatoren e komandantit legjendar Adem Jashari", ka shkruar Tahiri.

Shtatorja e Adem Jasharit do të vendoset afër ndërtesës së Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës.

# Në dhjetor arrijnë 100 000 vaksina kundër gripit

Ministria e Shëndetësisë ka porositur 100 000 vaksina kundër gripit, prej tyre 500 doza pediatrike, të cilat do të sigurohen përmes shërbimeve të prokurimit të UNICEF-it. Vaksinat e porositura pritet të arrijnë në Kosovë në ditët e para të dhjetorit



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike kanë njoftuar se në kuadër të parandalimit të gripit sezonal, MSh-ja i ka porositur 100 000 vaksina kundër gripit (prej tyre 500 doza pediatrike), të cilat do të sigurohen përmes shërbimeve të prokurimit të UNICEF-it.
Vaksinat e porositura pritet të arrijnë në Kosovë në ditët e para të dhjetorit.
Vaksinat kundër gripit sezonal, të cilat do të përdoren sivjet, sipas rekomandimeve të bëra nga OBSh, do të jenë katërshtamëshe, që e rrisin fuqinë mbrojtëse ndaj viruseve më agresive në qarkullim të gripit sezonal.
Vaksinat janë të dedikuara për t'i mbrojtur grupet më të ndjeshme të popullatës, si të moshuarit dhe të prekurit nga sëmundjet kronike.
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i siguron qytetarët se po e monitoron me kujdes situatën epidemiologjike në vend dhe do t'i mbajë ata të informuar në vazhdimësi, përfshirë këtu edhe informimin për arritjen dhe shpërndarjen e vaksinave.
Vaksinat e blera nga MSh-ja do t'i shpërndahen popullatës përmes IKShKP-së dhe Njësive të Vaksinimit në QKMF-të e Kosovës.

# Komitetet e Përhershme, garanci për funksionim të organeve komunale më transparente dhe efikase

EPOKA E RE Qendresa RAMA



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) së bashku me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) organizuan punëtorinë për të diskutuar për "Draft-Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komuna".
Punëtoria kishte për qëllim njohjen me kornizën ligjore për organizimin dhe funksionimin e komiteteve në komuna dhe identifikimin e sfidave të organizimit dhe funksionimit të komiteteve obliguese. Pjesëmarrës në punëtori ishin kryesuesit e kuvendeve komunale, përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shoqëria Civile. Ky udhëzim rregullon procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komunë. Kuvendi i Komunës ka nevojë për organe ndihmëse me qëllim të shqyrtimit të hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës, nga njëra anë, si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarive të degës ekzekutive, në anën tjetër. Megjithatë, këto komitete janë trupa ndihmës të Kuvendit të Komunës, që përmes tyre të garantohet që organet e komunave të jenë më transparente, më efikase dhe t'u japin llogari qytetarëve. Andaj, takimi kishte për qëllim për t'i rikujtuar obligimet ligjore në raport me procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komuna. Gjithashtu, të paraqiten përvojat më të mira dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar apo ballafaqohen në kuadër të organizimit dhe funksionimit të këtyre komiteteve.
Synim i konsultimit për këtë Draft-Udhëzim Administrativ ishte që të sigurohen opinionet, komentet dhe rekomandimet nga grupet e caktuara të interesit përkitazi me dispozitat e këtij Draft-Udhëzimi. Megjithatë, rëndësia e konsultimit publik me aktorët përkatës do të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e përmbajtjes së këtij Draft-Udhëzimi Administrativ.
Instituti KLGI nëpërmjet programeve edukative punon për ngritjen e kapaciteteve të komunave të vendit. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit 'Mbështetje për Komuna më të Forta dhe më të Qëndrueshme (SSSM)', i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

# Qeveria japoneze dhuron pajisje në vlerë 1.3 milion euro për QKUK-në

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka përfituar si donacion 1.3 milion euro donacion nga Qeveria e Japonisë. Në ceremoninë e dorëzimit të pajisjeve ka marrë pjesë edhe ambasadori i Qeverisë së Japonisë, Kiyoshi Koinuma.
Drejtori i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, me këtë rast ka thënë se me pajisjet e ardhura nga qeveria japoneze për herë të parë do të fillojë intervenimi në tru. "Është planifikuar për herë të parë të fillojë intervenimi në tru dhe javën e ardhshme presim edhe pajisjen të cilën e kemi blerë dhe në kombinim me donacionin do të shërbejnë për të mirën e pacientëve që të trajtohen në mënyrë profesionale dhe sa më lirë", ka theksuar Sejdiu.
Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka njoftuar se vlera e donacionit është 1.3 milion euro, kurse pajisjet e dhuruara po u shërbejnë pacientëve duke u mundësuar që mos të kërkojnë ndihmë në klinikat private. "Pamë për së afërmi se pajisjet në shumë klinika kanë filluar të përdoren, pacientët kanë filluar të marrin shërbime me pajisjet e reja duke u mundësuar atyre që mos të kërkojnë shërbime jashtë spitaleve publike, por të gjejnë shërbime në spitalet publike", është shprehur Ismaili.
Ndërsa ambasadori i Qeverisë së Japonisë, Kiyoshi Koinuma, ka theksuar se ky donacion vjen pas marrëdhënieve të mira që kanë Japonia dhe Kosova. Ai ka deklaruar se Japonia do të vazhdojë ta mbështesë shtetin e Kosovës.



# Koalicioni Nisma-AKR-PD nuk e pranon rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit

Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca Kosova e Re nuk e kanë pranuar rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit të shpallur nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ku koalicioni Nisma-AKR-PD nuk ka arritur ta kalojë pragun prej pesë përqindësh. Zyrtarët e këtyre dy partive, Endrit Shala dhe Behgjet Pacolli, kanë thënë se ky rezultat është i manipuluar që nuk e pasqyron vullnetin e popullit të Kosovës. Ata kanë thënë se do t'i shfrytëzojnë për ankimim të gjitha instancat e mundshme bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës




EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Endrit Shala, të enjten ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka folur lidhur me rezultatet përfundimtare që i ka shpallur Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ). Shala ka thënë se KQZ-ja nuk i shpalli rezultatet nga votat e rregullta dhe sipas ligjit në fuqi, por shpalli rezultate të fabrikuara, të prodhuara nga ajo vetë, duke i numëruar si vota këto pako me zarfe të cilat janë grumbulluar diku në Serbi, që nuk dihet ku e kanë identitetin. Thënë thjesht, këto pako me zarfe nuk dihet se nga cili qytet i Serbisë e kanë origjinën. Gjithashtu, Shala ka thënë se po flasin për pako me zarfe të mbledhura diku në Serbi, në një vend privat, nga persona të paidentifikuar, të paautorizuar dhe në kundërshtim me të gjitha ligjet e Kosovës në fuqi.

Më tutje, anëtari i kryesisë së Nismës ka thënë se këto pako me zarfe KQZ-ja në kundërshtim me ligjin i kontrabandoi në QNR, për t'i futur pastaj në mënyrë të paligjshme në rezultatin e zgjedhjeve për të prodhuar dhe prezantuar rezultate të fabrikuara dhe me vota të paligjshme. "Ne rezultat përfundimtar të zgjedhjeve e njohim atë që ka dalë nga votat e rregullta dhe në përputhje me Ligjin për zgjedhje, e që Nismën dhe koalicionin tonë e nxjerrin me mbi 5 për qind të votave", ka thënë Shala gjatë kësaj konference për media. Po ashtu, Shala ka pohuar se si Nismë dhe koalicion kërkojnë ligjshmëri dhe për këtë do të ankimohen në të gjitha instancat e mundshme bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Pra, presim nga institucionet ta shqyrtojnë ankimimin tonë që të vendosin duke e respektuar ligjin në fuqi, sepse çdo veprim kundër ligjit është goditje e rëndë për shtetin ligjor", ka thënë ai.

Në fund të kësaj konference, anëtari i kryesisë së Nismës, Endrit Shala, ka thënë se në një vend të lirë dhe demokratik, ku mbizotëron ligji, askush nuk ka të drejtë që me veprime të paligjshme të deformojë dhe as t'ua marrë të drejtën për përfaqësimin e tyre në parlament, të shprehur përmes votës së lirë mbi 42 mijë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

## Pacolli: Rezultati i zgjedhjeve, i manipuluar

Edhe presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka komentuar shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit nga ana e KQZ-së, sipas të cilave, koalicioni Nisma-AKR-PD nuk e ka kaluar pragun. Pacolli ka thënë se rezultatet e zgjedhjeve paraqesin një rezultat të manipuluar që nuk e pasqyron vullnetin e popullit të Kosovës. "Sot Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit. Rezultatet paraqesin një rezultat të manipuluar që nuk e pasqyron vullnetin e popullit të Kosovës. Përfshirja në numërimin e votave nga Serbia që janë dorëzuar në kundërshtim me ligjin dhe të cilat janë plotësuar kryesisht nga një person që përfaqëson Vuçiqin dhe Daçiqin në Kosovë është një skandal dhe një gabim historik. Ne do t'i përdorim të gjitha mjetet ligjore për ta parandaluar këtë gabim të rëndë për demokracinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".



## Aktakuzë për terrorizëm për të kthyerin nga Siria në Kosovë



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj A. M. për shkak të veprës penale "organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist". Përmes një njoftimi Prokuroria Speciale tha se i pandehuri A. M. kishte udhëtuar qëllimshëm drejt Sirisë për t'u bërë pjesë e grupit militant Shteti Islamik (ISIS). "I pandehuri A. M., me të arritur në Siri, i është bashkëngjitur organizatës terroriste ISIS ku, pas trajnimeve taktike dhe luftarake, ka marrë pjesë aktive në luftërat e Sirisë. Më 26.07.2017 është arrestuar nga forcat kurde, ku ka qëndruar deri më 19.04.2019, me ç'rast edhe është riatdhesuar në Kosovë", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës.

I njëjti bën të ditur se A. M. në vitin 2015 kishte udhëtuar fillimisht drejt Maqedonisë [tani të Veriut], ku kishte kontaktuar përkrahës të grupit militant Shteti Islamik dhe, pastaj, me pasaportë të falsifikuar kishte udhëtuar përmes Greqisë në Stamboll, nga ku kishte kaluar në Siri. Në muajin prill të këtij viti institucionet e Kosovës, në bashkëpunim me ShBA-në, kanë kthyer në Kosovë 110 kosovarë, duke përfshirë: katër luftëtarë, 32 gra dhe 74 fëmijë që ishin duke qëndruar në kampe refugjatësh në Siri.

# Stabiliteti i Kosovës është parakusht kyç për tërheqjen e investimeve

Prishtinë, 7 nëntor (ER) - Marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore, fuqizimi i sundimit të ligjit, luftimi i korrupsionit dhe rritja e stabilitetit të Kosovës dhe tërë rajonit janë kyçe për rritjen e investimeve amerikane. Kjo u konkludua gjatë një takimi të bizneseve anëtare të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë me Robert Morgan, Zyrtar Ekonomik Rajonal në Zyrën për Çështje të Evropës Jugore dhe Qendrore të Departamentit Amerikan të Shtetit

Në takim me udhëheqësit afaristë të Odës Amerikane, Zyrtari i Departamentit të Shtetit, Robert Morgan, ka thënë se stabiliteti është esencial për tërheqjen e investimeve, duke theksuar se vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm për rritjen ekonomike. Ai lavdëroi udhëheqësit afaristë të Odës Amerikane për vazhdimin e ndërtimit të perceptimeve pozitive për Kosovën përmes partneriteteve të tyre ndërkombëtare duke theksuar se shumë biznese në Shtetet e Bashkuara kanë pak informata rreth Kosovës. Sipas Morganit, angazhimi dhe përparimi pozitiv me fqinjët do ta ndihmonte në këtë aspekt.

Nga ana e tij, Morgan u zotua se ai do ta përçojë në Uashington dhe në mesin e komunitetit afarist të Shteteve të Bashkuara mesazhin për mundësitë e investimeve në Kosovë. Në fund, Morgan inkurajoi Odën Amerikane të vazhdojë ta përdorë ndikimin e saj për ta inkurajuar qeverinë e ardhshme të ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e sundimit të ligjit dhe të mjedisit afarist.




Ndërsa anëtarët e Odës Amerikane e njoftuan Zyrtarin nga Departamenti Amerikan i Shtetit për sfidat dhe për mundësitë e të bërit biznes në Kosovë. Ata shprehën shqetësimet e tyre për sundimin e dobët të ligjit, për nevojën e përmirësimit të zbatueshmërisë së kontratave, për mungesën e transparencës financiare, si sfida kryesore që aktualisht pengojnë operimin e bizneseve dhe rritjen ekonomike në Kosovë. Pjesëmarrësit, po ashtu, theksuan nevojën për konstituim sa më të shpejtë të institucioneve pas zgjedhjeve të fundit parlamentare, vazhdimin e reformave në mjedisin e të bërit biznes në përgjithësi, reformën fiskale dhe gjyqësore në veçanti, përfshirë këtu edhe krijimin e gjykatës komerciale.

Mes të tjerash, gjatë këtij takimi u bisedua edhe për përmirësimin e imazhit të Kosovës si dhe për ngritjen e vetëdijesimit të investitorëve të jashtëm mbi kapacitetet dhe zhvillimet e shumta ekonomike të vendit.

# 30 tonë mbeturina të riciklueshme më pak në kuadër të kampanjës vetëdijesuese ‘Ruje mos e gjuj’

Prishtinë, 7 nëntor (ER) - Green Art Center-Prishtina (GAC), në kuadër të kampanjës "Ruje mos e gjuj", kampanjë kjo që financohet prej "Coca Cola HBC" dhe implementohet në partneritet me MMPH-në, komunat përkatëse dhe disa institucione publike dhe private në Kosovë, shihet të jetë treguar e suksesshme, duke raportuar se janë mbledhur mbi 30 tonë mbeturina të riciklueshme (plastikë dhe alumin) gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore të implementimit të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në disa institucione universitare në Prishtinë dhe në 500 amvisëri në Vushtrri.




Zyrtarët e GAC-it raportojnë se, pavarësisht prej faktit se ky proces i ndarjes në burim po përballet me sfida kryesisht në institucionet universitare, ku shpeshherë mbeturinat po përzihen, në pjesën tjetër të aktorëve që janë pjesë e këtij projekti ndarja e mbeturinës së riciklueshme po realizohet shumë mirë prej anës së qytetarëve. Kjo kampanjë iu bashkëngjitet aktiviteteve të GAC-it si organizatë e cila tashmë, me përkrahjen e donatorëve të ndryshëm, po arrin ta shtrijë skemën e riciklimit të mbeturinave në disa komuna pilote në Kosovë.

Kësisoj, ky proces i rëndësishëm për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi, po përballet me sfida të shumta ku, përpos vetëdijes qytetare, krijimit të parakushteve për ofrimin e infrastrukturës për ndarje në burim, duhet të analizohet dhe sigurohet tregu i grumbulluesve të mbeturinave të riciklueshme, mundësia e tyre në përfshirje në sistem, dhe ku paraprakisht të krijohen mundësi për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave të riciklueshme me qëllim që sistemi të jetë i qëndrueshëm.

## Ministria e Financave mban ankandin e 15-të të letrave me vlerë për vitin 2019

Prishtinë, 7 nëntor (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 14 nëntor do të mbahet ankandi i pesëmbëdhjetë me radhë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (tri vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave. Sipas kësaj ministrie, për hollësi rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.



# Haradinaj: 29 projektligje i dedikohen zhvillimit ekonomik

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shpalosur të enjten të arriturat dhe raportin e punës "Qeverisja Haradinaj II". Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se 29 projektligje janë me ndikim të drejtpërdrejtë dhe i dedikohen zhvillimit ekonomik. "Njëkohësisht, 18 vendime të qeverisë janë për kreditë ndërkombëtare, 15 vendime për zonat ekonomike në Kosovë, 42 vendime janë me ndikime financiare drejtpërdrejt për ekonominë. Janë aprovuar 10 dokumente zhvillimore, 22 marrëveshje ndërkombëtare, katër vendime janë me ndikim në sferën e energjisë", ka thënë Haradinaj

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur të enjten një konferencë për media në të cilën ka shpalosur të arriturat dhe raportin e punës "Qeverisja Haradinaj II". Para gazetarëve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka thënë se qeveria nën drejtimin e tij ka miratuar 140 projektligje, 70 akte nënligjore të miratuara në mbledhje të qeverisë, 256 akte nënligjore të nxjerra nga ministrat në kuadër të fushëveprimit të tyre. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se 29 projektligje janë me ndikim të drejtpërdrejtë dhe i dedikohen zhvillimit ekonomik. "Njëkohësisht, 18 vendime të qeverisë janë për kreditë ndërkombëtare, 15 vendime për zonat ekonomike në Kosovë, 42 vendime po ashtu janë me ndikime financiare drejtpërdrejt për ekonominë. Janë aprovuar 10 dokumente zhvillimore, 22 marrëveshje ndërkombëtare, katër vendime janë me ndikim në sferën e energjisë", ka thënë kryeministri në detyrë Haradinaj.

Më tej, Haradinaj ka theksuar se gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 41 koncept-dokumente të rëndësishme, është miratuar buxheti për vitin 2019, që është 2 miliardë e 374 milionë euro, 612 milionë euro, është buxhet më i madh sesa na vitin 2017, apo 32 për qind më i lartë brenda dy vjetëve. "Rritja e bruto produktit vendor për vitin 2019 është 4.7 për qind, më e larta deri më tash dhe investimet kapitale në vitin 2019 kanë arritur në 700.89 milionë euro, apo 329 milionë më shumë se në vitin 2017", u shpreh kryeministri në detyrë Haradinaj. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka pohuar se numri i të punësuarve nga 2017 deri në korrik 2019 është rritur për 30.648 apo 10 për qind.

Sipas kryeministrit në detyrë, Haradinajt, disa projekte që kanë peshë të veçantë janë: zbatimi plotësisht i Ligjit për Trepçën, Ligji për Ushtrinë, pavarësimi energjetik, Ligji për Paga, Ligji për Kryeqytetin, vendime që vërtet efektet e tyre do të jenë të vazhdueshme si për zhvillimin e brendshëm shoqëror ekonomik, të sigurisë, por edhe për pozicionin e Kosovës në planin rajonal dhe më gjerë.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka ofruar edhe materialet që i ka përgatitur qeveria për dialog në etapa të ndryshme, njëkohësisht qëndrimet politike të njohura si 'position paper" në çaste veç e veç. Duke falënderuar për kohën dhe bashkëpunimin përgjatë këtyre viteve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve që kishin të bënin me liberalizimin e vizave, arsimin, zhvillimet politike në vend dhe çështje me rëndësi për vendin dhe qytetarët.



# Fabrika e ngjyrave 'Relux', biznes i diasporës në Kosovë, fillon eksportin në Kinë

PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Fabrika prodhuese e ngjyrave "Relux", biznes i suksesshëm i bashkatdhetarëve nga Gjermania, të enjten ka nisur kontingjentin e parë të ngjyrave drejt Kinës. Duke qenë se Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike u ka dhënë mbështetje të vazhdueshme bizneseve të diasporës në Kosovë, një grup zyrtarësh nga MDIS vizituan kompaninë në fjalë për ta uruar për suksesin e arritur.

Zyrtarët nga Departamenti për Hulumtim dhe Përkrahje të Investimeve të Diasporës, të udhëhequr nga drejtoresha Shqipe Krasniqi, i ka siguruar për mbështetjen e MDIS-it. Përfaqësuesit nga MDIS shfrytëzuan rastin ta vizitojnë edhe linjën e re të prodhimit nga produktet e gurit deri në arritjen e produktit final për prodhimin e bazave të ndryshme për ngjyra dhe fasada, ngjyra të brendshme dhe të jashtme si dhe fasada dekoruese.

Fabrika e ngjyrave "Relux" ka një përvojë mbi 25-vjeçare dhe eksporton edhe në shumë shtete të tjera të BE-së si në: Gjermani, Holandë, Slloveni, Austri etj. Të gjitha produktet e saj janë të certifikuara me ISO 9001 dhe CE.



## Komuna e Kamenicës dhe FSK-ja organizojnë ushtrime simulante

KAMENICË, 7 NËNTOR (ER) - Komuna e Kamenicës, në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), do të organizojë disa ushtrime në këtë komunë. Këto ushtrime do të realizohen si simulime të gjendjeve emergjente në rast të ballafaqimit me to. Këto dy institucione kanë krijuar 11 situata të ndryshme simulative, të cilat do të realizohen nga 11 deri më 13 nëntor. "Situata e parë do të nisë në shkollat e mesme në Kamenicë, me paramendimin se po ndodhë një termet 5.5 shkallë. Në këtë proces do të përfshihen dhe do të jenë në vendin e ngjarjes Policia e Kosovës, Zjarrfikësit, Kryqi i Kuq, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kamenicë, FSK-ja dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

Sipas këtij njoftimi, drejtoresha për Mbrojtje dhe Shpëtim, Pajtesa Kryeziu, në një takim me të gjithë aktorët ka ndarë përgjegjësitë dhe ka treguar në hollësi se si do të realizohen këto ushtrime simulative. Sipas saj, është shumë i rëndësishëm promovimi i zhvillimit të kapaciteteve për rastet emergjente. Me këtë rast, drejtoresha Kryeziu ka apeluar te qytetarët të mos krijojnë panik nëse gjatë këtyre ditëve të parapërgatitjeve shohin FSK-në, policinë, zjarrfikësit e të gjithë aktorët e tjerë. "Nga dita e premte do ta fillojnë përgatitjen e vendqëndrimeve (shtabeve të tyre) dhe e gjitha do të jetë vetëm për ushtrimet simulante", ka thënë ajo.

Komuna e Kamenicës në oborrin e objektit të vet do ta ngritë qendrën operative dhe emergjente.



# Përurohet biblioteka e shkollës 'Fehmi Lladrovci' në Drenas

DRENAS, 7 SHTATOR (ER) - Shkolla e Mesme Profesionale "Fehmi Lladrovci" në Drenas është bërë me bibliotekë të re. Në përurimin e kësaj biblioteke kanë marrë pjesë kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, drejtori i kësaj shkolle, Lulzim Nika, drejtorë të shkollave të tjera, stafi i shkollës dhe nxënës.

Kryetari Lladrovci ka theksuar se me përurimin e kësaj biblioteke vlera e kësaj shkolle do të jetë edhe më e madhe pasi që libri është miku më i mirë i njeriut i cili hap dyert e së ardhmes drejt diturive të reja, sidomos për gjeneratat e reja siç janë nxënësit e kësaj shkolle. Ai ka uruar shkollën "Fehmi Lladrovci" për të arriturat që ka treguar, ku si rezultat i arritshmërive ka fituar edhe donacione të ndryshme që janë investuar në objektin e shkollës, si kabinete të informatikës dhe salla të tjera.



Ndërsa drejtori i kësaj shkolle, Lulzim Nika, ka falënderuar kryetarin Lladrovci për mbështetjen që është duke ua dhënë institucioneve arsimore dhe ka shtuar se me renovimin dhe rregullimin e bibliotekës së shkollës janë plotësuar kushtet edhe me të mira për të vijuar një proces të mirë e me suksese në mësimnxënie e mësimdhënie.

Rregullimi i bibliotekës së shkollës "Fehmi Lladrovci" është bërë me buxhet të kësaj shkolle, ndërsa nga donacionet e ndryshme si të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe të tjera, kjo bibliotekë është pasuruar me tituj të ndryshëm të librave që, po ashtu, numëron një numër të madh të lexuesve, ku vetëm brenda një viti kalon mbi 1 000 anëtarësime të reja. Kjo shkollë gjatë këtij viti ka marrë donacion edhe 60 kompjuterë, duke krijuar kështu dy kabinete të informatikës. Po ashtu, në muajin tetor shkolla në fjalë ka fituar donacion nga Ministria e Arsimit për ta krijuar klasën digjitale në vlerë mbi 40 mijë euro, si dhe një kabinet të drejtimit dizajn-konfeksion në vlerë mbi 12 mijë euro, po me mbështetje nga MAShT-i.

# Në Podujevë u mbajt diskutimi me nxënës për luftën kundër trafikimit të njerëzve



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Me rastin e fushatës vetëdijesuese kundër trafikimit të njerëzve, e cila ka filluar më 18 tetor të këtij viti, Zyra e Sekretariatit të Strategjive e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e mbështetur nga ICITAP-i, mbajti një tryezë në Podujevë, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve mbi këtë fenomen.

Në kuadër të fushatës janë duke u mbajtur takime të rregullta në komunat e Republikës së Kosovës, ndërsa sot takimi u mbajt në Komunën e Podujevës, ku me ndihmën e Stacionit Policor të Podujevës dhe Drejtorisë së Arsimit të kësaj komune, tryeza u mbajt me nxënësit e Shkollës së Mesme Ekonomike "Isa Boletini". Përfaqësues të Autoritetit Kombëtar Anti Trafikim diskutuan për fenomenin e trafikimit të njerëzve në Kosovë, duke vënë në dukje angazhimet e institucioneve të Kosovës në luftën kundër këtij fenomeni. Me këtë rast, në bashkëbisedim me nxënës, u diskutua për parandalimin e hershëm dhe për shenjat e para që nxënësit mund të vërejnë për një rast potencial të trafikimit, me qëllim të njoftimit të autoriteteve të Kosovës. Fushata vetëdijesuese ka për qëllim përfshirjen sa më të gjerë të shoqërisë kosovare në përgjithësi, në mënyrë që të gjithë së bashku, duke kontribuar në luftimin e këtij fenomeni tejet negativ, të parandalohet trafikimi i njerëzve.

## Malisheva, një prej komunave më të qeta dhe më të sigurta në vend

MALISHEVË, 7 NËNTOR (ER) - Në Komunën e Malishevës është mbajtur mbledhja e pestë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e cila është drejtuar nga nënkryetari i kësaj komune, Hajdin Berisha. Në këtë mbledhje është vlerësuar situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, ku është vlerësuar se Malisheva vazhdon të mbetet një prej komunave më të qeta dhe më të sigurta në vend, në aspektin e sigurisë së përgjithshme.

Bazuar në raportet e organeve përgjegjëse për sigurinë e përgjithshme, situata e sigurisë në Komunën e Malishevës vlerësohet e qetë, pa tendencë të prishjes së kësaj situate. Në raportimin e tij, komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, në raportet policore, krahasuar me vitin paraprak, ka thënë se ka rënie të veprave penale në territorin e kësaj komune. Po në këtë takim situata me ethet hemorragjike krime kongo është vlerësuar në kontroll të plotë, pasi tani e gjashtë vjet me radhë nuk ka asnjë rast të vdekjeve nga ky virus në territorin e Komunës së Malishevës.



# Kujdes me fqinjët: As superioritet dhe as inferioritet, por dinjitet



Prof. Dr. Lisen BASHKURTI

Jemi në Ballkan. Teoria "zero probleme me fqinjët" është sa utopike, aq dhe diletante. Ballkani vazhdon të njihet dhe konsiderohet si "fuqi baroti". Kjo sepse Ballkani është një fabrikë e ndryshkur nacionalizmash.
Konfrontimi i nacionalizmave ballkanikë e shndërroi këtë rajon në një "fuqi baroti". Kësaj "fuqie" i hodhën benzinë edhe Fuqitë e Mëdha në sisteme të ndryshme ndërkombëtare. Aq thellë është ngulur metafora "fuqi baroti" në kujtesën ndërkombëtare për Ballkanin saqë është tejet e vështirë që imazhi i tij të ndryshojë. Përkundër gjithë kësaj situate mjerane imazhi, shtetet e Ballkanit, në vend se të punojnë së bashku për ta ndryshuar imazhin e tyre, vazhdojnë diku më shumë e diku më pak t'u rikthehen recidivave të së kaluarës.

## Supremacia greko-serbe...

Për më shumë se një shekull e gjysmë nacionalizmat greke (megaliidea) dhe serbe (Nacertanie) kanë synuar t'i shtrijnë hapësirat e tyre gjeopolitike mbi territore e popuj të tjerë, kryesisht shqiptare.
Nacionalizmi grek i rrëmbeu shqiptareve rreth 17 mijë kilometra katrorë, gjithë Çamërinë. Ndërsa nacionalizmi serb i rrëmbeu shqiptarëve mbi 30 mijë kilometra katrorë, deri në Molle të Kuqe.
Në tërësi populli shqiptar u tkurr prej agresionit grek e serb nga 92 mijë kilometra katrorë në rreth 40 mijë kilometra katrorë që iu përkasin dy shteteve shqiptare, Shqipëri e Kosovë.
Kjo dramë historike shqiptare është konsideruar triumf grek e serb mbi shqiptarët. Në rrafshin politik e diplomatik ky triumf është kthyer në një sjellje stereotipa supremacie greke e serbe mbi dy shtetet shqiptare. Të dy këto shtete, Greqia e Serbia, nuk po arrijnë dot të çlirohen nga hijet e mëngjesit. Pra, nuk po heqin dorë nga recidivat e së kaluarës ndaj shqiptarëve.

## Inferioriteti shqiptar ka marrë fund

Shqiptarët janë realitet diakronik, pra i thellë dhe dioptrik, pra i gjerë ballkanik. Milan Shuflai, albanologu i madh slloven, me të drejtë thoshte se "çdo histori për Ballkanin fillon me shqiptarët".
Në kohët moderne shqiptarët kanë lënë pas "mëkatet" e së kaluarës dhe po ndriçojnë si populli më konsistent pro perëndimorë në Ballkanin Perëndimor.
Nga kjo aleancë e pathyeshme shqiptarët fituan dy shtete të pavarura e sovrane, Shqipërinë dhe Kosovën, si dhe po zgjerojnë hapësirat e lirive etnike dhe njerëzore edhe në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe në Greqi. Realitetet kanë lëvizur pro faktorit shqiptar që po fiton përmasa, fuqi dhe status në rritje në hapësirën gjeopolitike ballkanike.

## Shqiptarët kërkojnë dinjitet

Duke mbajtur parasysh ndryshimet e mëdha në peizazhin politik ballkanik, politika dhe diplomacia shqiptare në qendrat shtetërore, Tiranë e Prishtinë, ose në qendrat etnopolitike në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Greqi, po kërkon ta rivendosë reciprocitetin në marrëdhëniet me fqinjët.
Vendosja e reciprocitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare është një normë e njohur, pranuar dhe respektuar ndërkombëtarisht. Hapi politiko-diplomatik i shqiptarëve në këtë drejtim diktohet nga një stad i ri i raporteve objektive shqiptaro-greko-serbe në Ballkan.
Për arsye mediokriteti, të ndikimeve politike e gjeopolitike apo për shkaqe të turbullta, mjaft njerëz të politikës dhe medies në Shqipëri e Kosovë po e interpretojnë këtë sjellje të re politiko-diplomatike shqiptare ndaj Athinës dhe Beogradit si një kalim ekstrem, nga trashëgimia e inferioritetit tek arroganca e superioritetit.

## Shqiptarët duan dinjitet

E vërteta është ndryshe. Sjellja politiko-diplomatike shqiptare ndaj Athinës e Beogradit nuk synon me as supremaci dhe as inferioritet, por dinjitet. Dinjiteti është morali legjitim i reciprocitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sidomos kur përmasat, fuqia dhe statusi i kombeve është i barabartë ose i përafërt siç janë në kohën tonë shqiptarët, grekët dhe serbët në Ballkan.
Pra, është koha as për superioritet dhe as për inferioritet, por për dinjitet. Politika dhe diplomacia shqiptare dinjitetin po kërkojnë. Dhe kanë të drejtë. Dhe me siguri do ta arrijnë...
Lehjet e zagarëve të rrugës nuk mund t'i ndalin dhe as t'i devijojnë shqiptarët nga destinacioni i tyre historik. Churchilli thoshte se "ai që vrapon pas zagarëve të rrugës nuk arrin kurrë në shtëpi".
Shqiptarët nuk do t'i ndjekin zagarët e rrugës, por do të ecin drejt destinacionit të tyre historik... një komb i bashkuar në Evropën e bashkuar. E kjo nuk bëhet mbi teorinë "zero probleme me fqinjët", por me doktrinën "dinjitet me fqinjët".

# Nëntori i Kthesës



Shkruan: Blerim REKA

Pas maratonës numëruese të votave dhe raundeve negociuese të fituesve të tyre, ky nëntor duket të jetë i kthesës. Pas nëntorëve historikë, ky do ta sjellë kthesën në qeverinë Kurti. Kjo qeveri LVV - LDK duhej të ndodhte dje dhe jo nesër, sepse jemi tepër të vonuar. Dy dekada pas luftës mjaftuan të kuptohet se çka nuk bën.
E para pas çlirimit dhe e dyta pas pavarësisë, nuk sollën sovranizimin e plotë. Kjo mbetet për dekadën e tretë, e cila do të jetë përcaktuese. Sepse 2019 nuk është as 2008 e as 1999. Në dekadën e parë pas çlirimit, Beogradi arriti ta bindë botën për "demokracinë" post-milloshevigiane, kurse në të dytën, për transformimin e tij nga fajtori në "viktimë". Derisa Kosova merrej me vetveten, Serbia merrej me të tjerët. Madje pa ndryshuar esencialisht asgjë nga 1999: as Kushtetutën, as narrativin kolonijalist e as establishmentin qeverisës. Me Preambulën e njëjtë, me ish-ministrat e njëjtë, e me pretendimet e njëjta për 'Kosovën Serbe'!
Derisa bota në vitin 1999 vendoste pa Serbinë, në vitin 2019 po vendos me Serbinë. Pas pavarësisë së Kosovës, Beogradi maksimalizoi doktrinën e tij: "edhe BE edhe Rusi" e, vitet e fundit, edhe Kinë e Turqi. Shantazhimi i Perëndimit, se do të shkojë në Lindje, gjatë shtatë vjetëve të dialogut të Brukselit, vetëm forcuan "pesëshen refuzuese" të pavarësisë së Kosovës. Sepse negociatat normalizuese të dy shteteve gati nuk përfunduan në negociata për statusin e njërit shtet! Kur shteti negociues pranoi të quhet me fusnotë, kurse BE-ja pranoi të ndërmjetësojë këto negociata, "pa paragjykuar statusin final" të njërit negociues, shtetet ndalën njohjet: nga 12, në vitin 2011 (kur filloi dialogu), në vetëm 1 njohje (në 2018-n, kur ai u ndal) dhe, 15 ç'njohje!
Serbisë i mjaftoi vetëm një dekadë (e dytë) bllokuese kundër dekadës (së parë) fituese të Kosovës. Madje edhe pas humbjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila në vitin 2010 qartësoi se shpallja e pavarësisë nuk shkeli të drejtën ndërkombëtare. Gjykata e OKB-së de jure ç'fuqizoi Rezolutën e po kësaj OKB-je (1244/99), të cilën de facto e kishte ç'fuqizuar realiteti. Mirëpo, "Dialogu i Brukselit" vetëm i ndihmoi Serbisë që ta minimizojë GjND-në, kurse dekadën e tretë e çeli me dy projekte finale për zhbërjen e shtetit të Kosovës. I pari plani i Vuçiqit, që nëse nuk mund ta kthejë tërë Kosovën, atëherë ta merr së paku çerekun e saj me idenë e tij për ndryshimin e kufijve. Por, pas pajtimit implicit të komisionarëve evropianë në ikje, QUINTI dhe ShBA-ja mbyllën planin e tij konform "3 JO-ve" (të vitit 1999): Jo kthim para 1999, jo ndryshime kufijsh dhe jo status quo. Pra, as ideja për kthimin serb të Kosovës, e as marrja e një pjese të saj, nuk kaloi në fund të vitit 2019.
Tash bashkësia ndërkombëtare po kërkon jo-në e tretë: mbylljen e amullisë: Prishtinë - Beograd. Kërkohet mbyllja e luftës së kontestit të fundit ballkanik me një paqe të pambyllur. Por, Serbia nuk ndalet. Pas humbjes së Kosovës në luftë (NATO, 1999) dhe në paqe (GjND, 2010), si dhe pas moslejimit të përvetësimit të veriut të Kosovës, Beogradi me projektin e ri të "Unionit Ballkanik" po tenton që së paku ta ruajë hegjemoninë rajonale. Nëse nuk mund t'i kthej kufijtë e ish-Jugosllavisë, atëherë ta kthejë dominimin serb në këta ish-kufij. Tash, me Rusinë brenda Serbisë dhe Serbinë brenda Unionit Euro-Aziatik. Nëse fizikisht nuk mund ta rikthejë Kosovën, atëherë së paku rajonalisht ta kontrollojë atë.
Qeverisë së re të Kosovës në dekadën e tretë i mbetet të merret me pasojat e qeverisjeve të dy dekadave të mëparshme: ta ç'kapë shtetin përbrenda dhe ta ç'getoizojë përjashta. Prandaj, negociatat me Serbinë do të jenë krejt ndryshe nga ato të mëparshmet. Me një kryeministër të pakorruptuar e të pakriminalizuar, vështirë do të mund të imponohen zgjedhjet e shantazhuara të dekadës së dytë. Beogradi edhe bota e di këtë fare mirë. Për fatin e Kosovës, nuk vendosin më dosjet e negociatorëve, por vetë negociatorët. Jo shpejtësia, por përmbajtja e negociatave. Kryeministri i ri, me asnjë ditë në qeveri e me shumë ditë në burg, nuk ka çka humb.

## Merkeli: Nuk kam të njëjtin vizion me Makronin



Berlin, 7 nëntor - Kancelarja gjermane, Angela Merkel theksoi të enjten në Berlin se nuk ndante vizionin "radikal" të presidentit francez, Emmanuel Macron, i cili e gjykoi NATO-n të jetë në gjendje të "vdekjes cerebrale".
"Nuk mendoj se një gjykim i tillë, i papërshtatshëm, të jetë i nevojshëm, edhe nëse kemi probleme, edhe nëse na duhet të rikuperohemi", shtoi kancelarja gjermane në një konferencë shtypi me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.
"Presidenti francez ka përdorur terma radikalë, gjë që nuk është pikëpamja ime për sa i përket bashkëpunimit brenda NATO-s", shtoi Merkeli.
Edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg e kundërshtoi këtë karakterizim të aleancës gjatë një konference të përbashkët shtypi në Berlin. Stoltenberg theksoi se NATO-ja mbetet e fortë duke zbuluar se ShBA-ja dhe Evropa po punojnë së bashku më shumë sesa dekada më parë.
Emmanuel Macron dënoi, në një intervistë të publikuar në të përjavshmen "The Economist", "vdekjen cerebrale të NATO-s". Ai shprehu keqardhje veçanërisht për mungesën e koordinimit mes ShBA-së dhe Evropës dhe sjelljen e njëanshme të Turqisë në Siri, anëtare e Aleancës Atlantike.
"Qëllimet strategjike të NATO-s duhet të sqarohen tashmë", theksoi Macroni një muaj para se të mbahet një samit i NATO-s, i parashikuar në Londër në fillim të dhjetorit.

# Zgjedhjet e së martës, shenjë inkurajuese për demokratët

Votuesit në periferi të zonave urbane votuan me shumicë dërrmuese për demokratët të martën, duke u dhënë atyre një avantazh që ata mund ta përdorin kundër presidentit Donald Trump në zgjedhjet presidenciale në vitin 2020

Uashington, 7 nëntor - Demokratët në Shtetet e Bashkuara po festojnë fitoret në zgjedhjet në shtetet e Virxhinias dhe Kentakit që, ndoshta, mund të jenë tregues të vështirësive që mund ta presin presidentin Donald Trump në fushatën e tij për të fituar një mandat tjetër në zgjedhjet e vitit të ardhshëm. Votuesit në periferi të zonave urbane votuan me shumicë dërrmuese për demokratët të martën, duke u dhënë atyre një avantazh që ata mund ta përdorin kundër presidentit në vitin 2020, ka njoftuar voa.
Falë mbështetjes nga votuesit në periferitë e zonave urbane, demokratët morën nën kontroll të dyja dhomat e legjislaturës në Virxhinia, një shtytje e madhe për guvernatorin demokrat të shtetit, Ralph Northam.
"Sot më 5 nëntor të vitit 2019 unë jam këtu për të deklaruar zyrtarisht se Virxhinia është zyrtarisht blu (demokrate). Urime!", tha Northam.
Demokrati Andy Beshear shpalli fitoren në garën për guvernator të Kentakit ndaj guvernatorit aktual, republikanit Matt Bevin. Beshear tha se ai fitoi duke e përqendruar vëmendjen në çështjet lokale, mbase një mësim për demokratët në mbarë vendin. "Mesazhi im do të ishte që kjo garë nuk ka të bëjë me atë që është në Shtëpinë e Bardhë, por për atë që po ndodh në shtëpinë tuaj", tha Beshear.
Bevin, mbase guvernatori më pak i popullarizuar në vend, ende nuk e ka pranuar humbjen, por kishte shpresuar se një shtytje në minutën e fundit nga presidenti Trump do ta çonte atë drejt fitores. "Kentaki është duke udhëhequr dhe ne mbështesim presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald J. Trump!", tha Bevin.
Presidenti pati fat më të mirë në Misisipin konservator, ku ai i dha mbështetje kandidatit fitues për guvernator, republikanit Tate Reeves. "Liberalët në vend besojnë se nëse mund të vijnë në Misisipi dhe të fitojnë këto zgjedhje, ata do të dëmtojnë presidentin Donald Trump në vitin 2020", tha ai.
Demokratët, përfshirë kryetarin e partisë Tom Perez, u inkurajuan nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit. "Fitorja e së martës ishte një fitore për të gjithë demokratët dhe, mendoj se ishte një fitore për vlerat tona demokratike dhe nuk mund të them mjaft për të gjithë partnerët e shkëlqyeshëm të përfshirë në këtë përpjekje", tha Perez.
Mbështetja për republikanët në mesin e votuesve në zonat periferike të qyteteve shënoi rënie në këto zgjedhje të fundit, dhe sondazhet tregojnë gjithashtu se presidenti po humbet terren me votuesit e pavarur ndërsa ai përgatitet për zgjedhjet e vitit të ardhshëm.
Presidenti Trump mbetet i përqendruar intensivisht në bazën e tij politike, thotë Susan Page. "Ndoshta surpriza më e madhe e presidencës së Trumpit, dhe unë e them këtë duke marrë parasysh të gjitha llojet e surprizave, është se ai që nga dita e inaugurimit të tij nuk është përpjekur të zgjerojë bazën e mbështetësve të tij. Ai është përqendruar pothuajse ekskluzivisht në forcimin e mbështetjes brenda bazës së tij të votuesve", tha Page.
Presidenti Trump ndodhet mbrapa rivalëve të tij kryesorë demokratë në disa sondazhe të reja kombëtare, por ai ka një paraqitje më të mirë në sondazhet me votuesit e shteteve të pavendosura, në të cilat ai fitoi me rezultat të ngushtë në vitin 2016.



## Serbia blen raketa nga Rusia, pavarësisht paralajmërimeve amerikane për sanksione



Beograd, 7 nëntor - Serbia pritet të pajiset shumë shpejt me një sistem të sofistikuar raketash ruse, edhe pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë paralajmëruar për sanksione të mundshme ndaj një akti të tillë.
Agjencia ruse TASS, raporton se bëhet fjalë pikërisht për sistemin raketor "Pancir" që do të dërgohet në Serbi në muajt e ardhshëm, sipas kontratës së nënshkruar.
Rusia e ka ndihmuar shpeshherë Serbinë të përmirësojë ushtrinë e saj me avionë, helikopterë dhe tanke, duke ngritur shqetësime në rajon dhe mbarë botën.
I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, gjatë vizitës në Beograd, e ka paralajmëruar Serbinë se blerja e armatimeve të tilla mund të rrezikojë vendosjen e sanksioneve.




AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”

Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë

Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333



E rrallë

## Filmoi nga ajri me dron, pretendon se ka regjistruar një krokodil shtatë metra



Një burrë që po filmonte nga ajri me dron ka arritur ta regjistrojë një pamje të pazakontë, një krokodil shtatë metra të gjatë në ujërat e njelmëta, që mund të konsiderohet si krokodili më i madh që ndonjëherë është filmuar. David Brockwell ishte në përfundim të montimit të videos pasi kishte filmuar nga ajri me dron, por gjatë procesit vërejti diçka të pazakontë, aty pa se ishte një krokodil gjigant në rërë.

FOTO E DITES




Disa punëtorë në shtetin verior të Asamit shihen duke nxjerrë rërë nga shtrati i lumit Beki. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Topat e çuditshëm prej akulli mbuluan një prej plazheve të Finlandës



Një fenomen shumë i rrallë ka ndodhur në bregdetin Hailuoto në Finlandë pasi janë formuar disa topa akulli të pazakontë. Hailuoto ndodhet në pikën më të largët në veri të Finlandës e cila e ndan atë nga Suedia. Një prej banoreve shprehet se është një fenomen i rrallë dhe magjepsës. Ajo jeton shumë afër bregdetit dhe shprehet se kjo gjë ka ndodhur edhe më parë, por jo në përmasa kaq të mëdha. Topat e akullit formohen kur uji i detit është i turbulluar dhe në temperatura të ulëta.

## BARSOLETA E DITËS



**Pacienti: A është e vërtetë që do të më operojë studentja?**
**Doktori: Po.**
**Pacienti: Çfarë ndodh nëse operacioni nuk do të ketë sukses?**
**Doktori: Studentja nuk do ta kalojë provimin.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjatë vikendit në ora 14:00**

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton




**Çdo ditë në ora 16:00**

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley




**Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00**

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning




**Çdo ditë në ora 22:00**

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Audienca juaj do ta ketë të gjithë vëmendjen te ju sot. Merrni drejtimin dhe të tjerët do t'ju ndjekin. Tregohuni vetvetja dhe drejtoheni zërin tuaj në auditorin e etur.



**DEMI**
Sot do të ndiheni të sigurt dhe do të keni një ide të qartë se çfarë doni. Informacioni është fuqi. Të tjerët janë duke punuar të ushtrojnë pushtet mbi ju.



**BINJAKËT**
Mendja juaj do të shpërthejë sot. Do të ndiheni sikur një grumbull i madh informacionesh që duhen përpunuar do ta pushtojë mendjen tuaj.



**GAFORRJA**
Përpiquni të mos fokusoheni te fjalët e të tjerëve sot. Ju mund të keni shpenzuar orë të tëra mposhtur vërejtjet.



LUANI
Tendencat afatgjata po arrijnë në një pikë të rëndësishme tani. Kjo periudhë dramatike theksohet nga sasia e shtuar e informacionit që ju merrni.



**VIRGJËRESHA**
Bëni një pushim nga ajo që jeni duke bërë. Shikoni se çfarë po bëjnë njerëzit rreth jush. Kontrolloni planet tuaja duke i lidhur me ato të të tjerëve.



**PESHORJA**
Përshtatuni me energjinë e sotme në mënyrë që të mos mbeteni jashtë grupit. Kontributi juaj për këta të fundit është mjaft i rëndësishëm.



**AKREPI**
Ju mund të shtoni më shumë mjete në kutinë tuaj të orendive sot. Shprehni shqetësimet që keni dhe do të gjeni mënyra për t'i zgjidhur.



SHIGJETARI
Bashkohuni me të tjerët para se të bëni plane të mëdha udhëtimesh. Ideja më e vogël mund të kthehet në një plan të madh.



**BRICJAPI**
Mos ngecni duke bërë të njëjtën gjë sot. Sa më të larmishme të jenë aktivitetet tuaja, aq më e lehtë do të jetë për ju të integroheni në çështje të ndryshme.



**UJORI**
Sot ju do të rrethoheni nga informacione që mund t'ju çojnë në një vorbull. Jeni një nga njerëzit më të përshtatshëm për t'u marrë me çështjet e ditës.



**PESHQIT**
Mund të jeni duke kërcyer nga njëri vend te tjetri sot. Kjo do të jetë një nga ato situatat që ju nuk doni të qëndroni në një vend për një kohë të gjatë.

# Ron Perlman shkurorëzohet nga gruaja



Ron Perlman po shkurorëzohet nga gruaja prej gati 40 vjetësh martesë, Opal Perlman. Aktori 69-vjeçar ka bërë kërkesë për prishjen e martesës dhe ai rendit datën e ndarjes së tyre më 10 maj 2019, sipas "The Blast". Ka pasur thashetheme se Ron dhe Opal ishin në një martesë të hapur, por kjo nuk është konfirmuar dhe ata nuk kanë komentuar rreth ndarjes. Ata u martuan në shkurt 1981 dhe kanë dy fëmijë. Tani thuhet se Ron është në lidhje me Allison Dunbar.

# Kylie Jenneri në lidhje me Draken?



Kylie Jenneri dhe Drake janë në një lidhje? Disa burime po thonë se diçka ka mes tyre. "Ai dhe Kylie kanë kaluar kohë bashkë së fundmi" ka thënë një burim për "People". "Ata janë miq që një kohë të gjatë dhe Drake është shumë afër familjes". Një burim tjetër insiston që çifti po takohen dhe kanë nisur një romancë, por një person tjetër është duke këmbëngulur se ata janë thjesht miq. Nëse nuk e dini, Kylie është ndarë muajin e kaluar me të dashurin Travis Scott.



# Kompromiset që Kimi ka bërë për Kanyen

Martesa kërkon punë dhe Kim Kardashiani e ka mësuar mirë këtë. Gjatë vizitës së saj në emisionin "The real", themeluesja e "KKW Beauty" foli për kompromiset që ka bërë për bashkëshortin prej pesë vjetësh, Kanye West. "Fëmijët po rriten. Ai është bërë më i kujdesshëm për çfarë mbajmë në shtëpi. Kemi hequr televizorin te dhoma e fëmijëve, e make up-in nga ajo e North. Ai ka pasur besimin e të qenit më tepër strikt si baba", është shprehur ylli i reality shout. Ndërkohë Kimi tregon se ajo ka pranuar shumë gjëra që Kanye bën që asaj nuk i pëlqejnë, por reperi ka vepruar njësoj me të.

# Publikohet një këngë e padëgjuar e George Michaelit



Një këngë e padëgjuar më parë e George Michaelit është publikuar për të parën herë në "BBC Radio 2". E titulluar "This Is How" (We Want You To Get High), melodia e këndshme dhe tërheqëse u incizua gjatë regjistrimeve përfundimtare të studios së yllit në vitin 2015. Përmes fjalëve të mprehta tregohet se si prindërit kalojnë zakonet e tyre më të këqija, me George duke thënë: "Unë gjithmonë do të përpiqem ta rregulloj jetën time". DJ Zoe Ball i "Radio 2" tha se u emocionua shumë kur dëgjoi këngën.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Gjilani zbret Ballkanin nga froni, Ferizaj merr tri pikë të arta kundër Flamurtarit

Gjilani dhe Ferizaj kanë shënuar fitore në dy ndeshjet e fundit të javës së katërmbëdhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Gjilani e mposhti Vushtrrinë (1-3) dhe në këtë mënyrë e mori pozitën e parë në elitë. Në ndeshjen tjetër Ferizaj mori tri pikë të arta në ndeshjen e 'mbijetesës' ndaj Flamurtarit (1-0)

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



**Prishtinë, 7 nëntor** - Skuadra e Gjilanit është lidere e re në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi arriti fitore në ndeshjen ndaj Vushtrrisë me rezultat 1-3.
Trajneri i Vushtrrisë, Fitim Llapashtica, ka thënë se moskonkretizimi i rasteve nga futbollistët vendëse bëri që në fund të dalë triumfuese skuadra e Gjilanit. "Në pjesën e parë e nisëm mirë, por na munguan golat dhe më pas, falë gabimeve tona, na ndëshkuan. Nuk kishim edhe fat, madje goditëm edhe shtyllën, por ky është futbolli. Sulmi ndaj gjyqtarit? Mendoj se ishte rrjedha e lojës që bëri të vinte deri tek ai sulm. Mendoj se gjyqtarët duhet të jenë më korrektë jo për ne si vendës, por për të gjithë. Po shihet se po bëhen gabime", ka thënë Llapashtica.
Gjilani ishte skuadër më e mirë se Vushtrria që nga fillimi dhe arriti ta mbyllë pjesën e parë me dy gola epërsi, derisa shënues ishin Razak Keita (19') dhe Armend Halili (44'). Pjesa e dytë ishte edhe më interesante, kurse pas një ore lojë gjyqtari i katërt, Burim Jahmurataj, është goditur me shkrepës nga shikuesit vendës, kurse gjyqtari kryesor i ndeshjes, Gramoz Shala, mori vendim që të zbrazet tribuna kryesore. Më pas ndeshja u zhvillua normalisht. Mysafirët e shënuan edhe golin e tretë nëpërmjet Prognit, kurse për Vushtrrinë golin e nderit nga gjuajtja e lirë e realizoi Bashkim Shala. Në minutat shtesë të ndeshjes Edison Kçiku i Gjilanit, pas dy kartonëve të verdhë, ndëshkohet me karton të kuq. Pas kësaj ndeshje Gjilani e merr pozitën e parë në tabelë me 30 pikë, aq sa ka edhe Ballkani i Ismet Munishit që bie në pozitën e dytë, ndërsa Vushtrria mbetet e parafundit me vetëm 9 pikë. "Më vjen mirë që fituam tri pikë, sepse vlejnë shumë për faktin se i morëm në fushë të vështirë. Lëndimet e lojtarëve erdhën paksa nga terreni i vështirë. Ne kemi objektiva dhe na duhet të shohim përpara pasi që ka shumë pikë deri në fund. Gjilani është skuadra më e dëmtuar për arsye të kartonëve, sepse në çdo ndeshje na janë dhënë shumë kartonë. Plot 48 kartonë të verdhë dhe dy të kuq janë bilanci ynë dhe gjyqtarët duhet ta shikojnë pak këtë dhe të jenë më objektivë sepse na janë dhënë shumë deri më tani", ka thënë Gentian Mezani, trajneri i Gjilanit.
Fitore të enjten arriti edhe skuadra e Ferizajt në ndeshjen e vlerësuar si derbi i mbijetesës kundër Flamurtarit. Tri pikët i takuan skuadrës vendëse që fitoi me rezultat 1-0, kurse golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Adonis Shala në minutën e 27. Pas këtyre tri pikëve skuadra e drejtuar nga Bekim Isufi ngritët në pozitën e nëntë me 12 pikë, kurse me pikë të barabarta një pozitë më poshtë renditet skuadra e Flamurtarit nga Prishtina.

## SHKURT

### Zbulohet orari i Kosovës në parakualifikimet e Kupës së Botës

Është publikuar orari për raundin e parë parakualifikues për Kupën e Botës 2023. Kosova ndodhet në Grupin B, ku do të përballet me Islandën, Sllovakinë dhe Luksemburgun. Dy kombëtaret e para të grupit kualifikohen në raundin e dytë. Ndeshjet do të zhvillohen nga 20 shkurti i vitit 2020 deri më 21 shkurt të vitit 2021. Takimin e parë Kosova do ta ketë ndaj Islandës në shtëpi më 20 shkurt 2020, derisa më 23 shkurt 2020 përballet me Luksemburgun në udhëtim. Në muajin nëntor "Dardanët" do të kenë dy ndeshje në udhëtim. Më 26 nëntor 2020 do të përballen me Sllovakinë, kurse më 29 nëntor me Islandën. Më 18 shkurt 2021 Kosova e pret Luksemburgun, kurse më 21 shkurt 2021 e pret Sllovakinë.

### Kosova mëson kundërshtarët për kualifikimet e Evropianit 2022 në futsall

Në Nion të enjten është hedhur shorti për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2022 në futsall, që do të mbahet në Holandë. Pjesëmarrës në tërheqjen e shortit ishte edhe delegacioni i FFK-së, me anëtarin e Komitetit Ekzekutiv, Ilaz Mjaku dhe administratorin e futsallit, Rinor Havolli. Kosova u përfshi në Grupin F, ku do të ketë për kundërshtarë Gjeorgjinë, Gjermaninë dhe Austrinë. Ndeshjet e rrethit të parë kualifikues do të mbahen në Gjeorgji, prej 29 janarit deri më 2 shkurt.

### Milani interesohet për Xhakën

AC Milan është duke u treguar i interesuar për futbollin shqiptar të Arsenalit, Granit Xhaka. Ky i fundit po kalon një periudhë të keqe në skuadrën angleze pasi gjatë zëvendësimit në ndeshjen ndaj Crystal Palaces pati një përplasje me tifozët dhe më pas ai nuk u grumbullua në disa ndeshje nga trajneri Emery, gjithashtu i është hequr edhe shiriti i kapitenit. Mediet kanë raportuar në Angli se Xhaka mund të shitet në janar, kurse në nën tjetër Milani ka shprehur dëshirën që ta transferojë mesfushorin që mbron ngjyrat e Zvicrës.

# Krasniqi publikon listën për kualifikimet në Uells



**Prishtinë, 7 nëntor** - Përzgjedhësi i Përfaqësueses U19, Ramiz Krasniqi, e ka bërë publike listën e futbollistëve me të cilët do të paraqitet në ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian, të cilat do të zhvillohen në Uells, prej 12 deri më 20 nëntor. Grumbullimi i futbollistëve do të bëhet më 10 nëntor në hotel 'Venus' në orën 11:00. Ndeshjen e parë Kosova e zhvillon më 13 nëntor kundër Rusisë, ndeshjen e dytë kundër Polonisë, më 16 nëntor dhe ndeshjen e fundit kundër Uellsit, më 19 nëntor. Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 13:00. Lista e futbollistëve: Petrit Terziu, Florent Demiri, Endrit Demolli, Altin Bytyçi, Blend Morina, Albin Krasniqi, Bujar Pllana, Albin Prapashtica, Adonis Aliu, Gentrit Halili, Qendrim Zyba, Hajdin Salihu, Arlind Shabani, Veton Tusha, Leonardo Uka, Valon Zumberi, Granit Berisha, Kevin Halabaku, Leart Sadriu, Artan Asani.

## Muriqi: Synimi im është kalimi në Angli

STAMBOLL, 7 NËNTOR - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, ka folur në lidhje me të ardhmen e tij. Ai mendon se do ta vazhdojë karrierën larg Turqisë dhe shpreson që të luajë në Angli. "Objektivi im i parë ishte të luaja për klube të mëdha nga Evropa. Kur erdhi oferta zyrtare nga Fenerbahçe ishte e vështirë që ta refuzoja. Ndryshimi i shtetit do të ishte i vështirë për mua, prandaj e vendosa afrimin me Fenerin dhe me gruan time. Ëndrra ime është Premierë Liga. Qëllimi im kryesor është Anglia, pasi më pëlqen si futboll dhe mendoj se më përshtatet duke u bazuar te mundësitë e mia fizike. Unë mora një pasaportë turke kur luaja me Giresunsporin dhe presidenti ka folur disa herë me trajnerin e kombëtares Fatih Hodja, u ndal gjithçka për shkak të problemeve me dokumentet", ka thënë Muriqi.



# Bushi: Anglia do ta ketë të vështirë ndaj nesh

TIRANË, 7 NËNTOR - Trajneri i Kombëtares i Shqipërisë U21, Alban Bushi, zbuloi listën e lojtarëve të grumbulluar për përballjen eliminatore të 15 nëntorit kundër Anglisë. Trajneri Bushi vlerësoi rëndësinë e sfidës dhe theksoj se ka besim te skuadra e tij se duke dhënë 100 % çdo lojtar do të arrijë të bëjë më të mirën, përtej faktit se kundërshtari që kemi përballë është ndër më të fortët në botë. "E dimë kush është Anglia. Ky është favor për ne, sepse e kemi ndjekur. Futemi gjithmonë të fitojmë, edhe nëse është Anglia, apo San Marino. Normalisht se në këtë ndeshje nuk do të futemi të bëjmë lojë sulmuese, por të bëjmë sulme të sakta, duke qenë një skuadër cinike. Strategjia është të mbrohemi mirë dhe të kundërsulmojmë. Anglia është ekip i madh, por nuk duhet pasur frikë. Edhe mund të fitojmë, të barazojmë apo humbim. Kemi luajtur me Italinë, Spanjën dhe Francën. Kemi pësuar për fajin tonë. Nëse nuk bëjmë gabime individuale, Anglia nuk na shënon. Po të jemi të bashkuar do ta kenë të vështirë. Edhe Spanja vetëm në fund na shënoi në 'Selman Stërmasi' kur luajtëm me të", ka thënë Bushi. "Kemi marrë tre lojtarë të rinj, si Tuci, Domi dhe Ismailgeci. Ata janë të rinj dhe luajnë në ekipet e tyre. Janë edhe në formë. Do të shohim në stërvitje se kush do të luajë nga fillimi. Kemi pasur probleme, pasi kemi tre lojtarë te U19, Tafa me kartonë, Vrioni i dëmtuar. Gjithsesi do të mundohemi që me këta lojtarë të bëjmë më të mirën", ka deklaruar Bushi. Më pas trajneri foli edhe për tifozët, pasi beson se do të jenë në numër të madh, sikurse edhe në të kaluarën. "Patjetër që është një ndeshje e rëndësishme për ne dhe për tifozët. Ata duhet të vijnë ta shohin Shqipërinë, pastaj Anglinë. Kemi bërë ndeshje të mira për ta respektuar flamurin, veten dhe tifozët. Duhet të dimë kush jemi dhe më kë luajmë. Kur jep maksimumin nuk është se kërkohet diçka më shumë, edhe nëse mundesh. Në Shkodër do të vijnë tifozët, kanë ardhur edhe më parë", ka shtuar trajneri i U21-shave. Ndeshja Shqipëri - Angli do të luhet në stadiumin "Loro Boriçi", në orën 19:00.



# Hardeni shkëlqen në fitoren e Houstonit ndaj Golden State

HOUSTON, 7 NËNTOR - U zhvilluan plot nëntë ndeshje në NBA, por vëmendjen kryesore e kishte përballja në "Toyota Center", ku Houston Rocketsi e shkatërroi 129-112 Golden State Warriorsin. James Hardeni realizoi plot 36 pikë e 13 asistime. "Mjekroshi" i famshëm i NBA-s pati gjithashtu ndihmën e PJ Tuckerit me 11 pikë e 11 "rebounde", që u shtohen edhe 19 pikë e 16 rikuperime të Clint Capelas. Në mungesë të Stephen Curryt, që do të qëndrojë për një kohë të gjatë në infermieri, pas ndërhyrjes në dorë, mori iniciativën në radhët e Warriors Alec Burks, që e mbylli takimin me 28 pikë. "Luftë" e fortë u zhvillua edhe në përballjen në mes të Dallas Maverickit e Orlando Magicit, por festa në fund ishte për vendësit, që triumfuan me vetëm një pikë diferencë, 107-106. Vazhdon të magjepsë Luka Donqiq, i cili rezultoi më i miri mbi parket me 27 pikë, 7 asistime dhe 7 "rebounde". Një tjetër ndeshje e madhe ishte ajo në mes të Los Angeles Clippersit dhe Milwaukee Bucks, e zhvilluar në "Staples Center", ku spikati me plot 38 pikë, 16 "rebounde" e 9 asistime i zakonshmi Giannis Antetokounmpo. Për të zotët e shtëpisë, në mungesë të Kawhi Leonardit, shënuan nga 34 pikë secili Montrezi Harrell dhe Lou Williams, por që rezultuan të pamjaftueshme për ta shmangur humbjen. Ndërkohë Toronto Raptors, kampionët në fuqi të NBA-së, mposhtën Sacramento Kingsin me 24 pikë, Kyle Lowry dhe 23 pikë, plus 13 "rebounde" të Pascal Siakamit.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Detroit P. - New York K. | 122-102 |
| Indiana P. - Washington W. | 121-106 |
| Houston R. - Golden State W. | 129-112 |
| Atlanta H.- Chicago B. | 93-113 |
| Toronto R. - Sacramento K. | 124-120 |
| Memphis G. - Minnesota T. | 137-121 |
| Dallas M. - Orlando M. | 107-106 |
| Utah J. - Philadelphia 76ers | 106-104 |
| LA Clippers - Milwaukee B. | 124-129 |

## SHKURT

